

VENDIM
Nr. 22, datë 25.4.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 25.4.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (N) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Nuri Peti

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1756 (262), datë 7.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkuarit Nuri Peti, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Avokaturës së Shtetit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar (*ARRSH*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarshi rezulton se ka pasur në pronësi në emrin e tij pronën me nr. pasurie 1/93, zona kadastrale 8280, me sipërfaqe prej 1850 m², të ndodhur në vendin e quajtur Rruga e Liqenit Tiranë, mbi të cilën është ndërtuar një godinë banimi 3-katëshe dhe pronën me nr. pasurie 1/95, zona kadastrale 8280, me sipërfaqe prej 453 m², të ndodhur në të njëjtën zonë.

2. Me njoftimin nr. 5613 prot., datë 23.9.2011 të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (*DPRR*), në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 8.6.2011 “Për shpronësimin për interes publik të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës” (*VKM nr. 408/2011*), kërkuarshi është njoftuar se duhet të dorëzojë dokumentacionin e plotë të pronësisë dhe numrin e llogarisë (IBAN), për likuidimin e vlerës së përcaktuar për shpronësimin, në përputhje me pikën 11 të kësaj VKM-je. Sipas VKM-së nr. 408/2011 rezulton se kërkuarshi është shpronësuar për interes publik për sipërfaqen prej 894 m², për

pasurinë nr. 1/93, e vlerësuar me 7,623,585 lekë, si edhe truallin me sipërfaqe prej 20 m², që i përket pasurisë nr. 1/95, e vlerësuar me 170,550 lekë, hotel. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vlerën e shpronësimit, ka bërë ankim administrativ.

3. DPRR-ja, me shkresën nr. 5765/1 prot., datë 6.10.2011, i ka kthyer përgjigje kërkuesit se në lidhje me rishikimin e çmimit për shpronësimin, për pasurinë truall dhe për hotelin, vlera e shpronësimit është përcaktuar nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 30.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar. Në këto kushte, kërkuesi, më datë 13.10.2011, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt ndryshimin e VKM-së nr. 408/2011 dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë diferencën e vlerës së pronës së shpronësuar.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 93, datë 14.1.2014, ka vendosur moskompetecën lëndore të saj për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykatë kompetente.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3406, datë 19.6.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesi [...]. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim palët e paditura, Avokatura e Shtetit dhe ARRSH-ja.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 416, datë 3.3.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3406, datë 19.6.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesi [...]. Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs palët në proces.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1756 (262), datë 7.7.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se ajo është paraqitur në gjykatë jashtë afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 24 i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar (*ligji nr. 8561/1999*) dhe në këto kushte gjykatat më të ulëta duhej ta kishin rrëzuar atë. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, afati 30-ditor për paraqitjen e kërkesëpadisë ka filluar në momentin e botimit në Fletoren Zyrtare të VKM-së nr. 408/2011, e cila është botuar më datë 21.6.2011, ndërsa kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë më datë 10.10.2011 (*shih paragrafin 34 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

8. Më datë 7.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar më datë 23.11.2022, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1756 (262), datë 7.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, më datë 27.1.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuesi, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

9.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1 *Së drejtës për t’u njoftuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin dhe përfaqësuesen e tij për zhvillimin e gjykimit. Gjithashtu, ai pretendon se nuk është njoftuar as për revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve dhe as për vijueshmërinë e gjykimit në dhomën e këshillimit. Mungesa e këtij njoftimi i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t’u mbrojtur nëpërmjet paraqitjes së pretendimeve me shkrim.

9.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar shkakun ligjor se përse vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhej të ndryshonin dhe kërkesëpadia të rrëzohej. Kolegji

Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme për afatin e paraqitjes së kërkesëpadisë në raport me momentin e botimit të aktit për shpronësimin në Fletoren Zyrtare.

9.2 *Të drejtën e pronës*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar kërkesit të drejtën për t'u njoftuar drejtpërdrejt nga autoritetet shtetërore për shpronësimin e realizuar, sipas procedurave të ligjit nr. 8561/1999. Gjithashtu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se afati i ankimit ndaj vendimit të shpronësimit fillon në momentin e botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe jo në momentin e njoftimit të drejtpërdrejtë nga autoritetet shtetërore, ka keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr. 8561/1999, duke cenuar të drejtën e pronës.

10. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar si vijon:

10.1 Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e pretendimeve të kërkesit, pasi ato kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, që për nga natyra hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Kërkesi nuk ka ngritur asnjë argument të natyrës kushtetuese.

10.2 Pretendimi për *cenimin e procesit të rregullt ligjor* është i pabazuar për arsyet e mëposhtme:

10.2.1 Lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, në rastin konkret nuk është kufizuar e drejta për akses në gjykatë, për sa kohë kërkesi nuk provon se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tij. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje edhe nga rekursi i paraqitur prej kërkesit. Gjithashtu, vendimi për revokimin e vendimit për kalimin e çështjes në seancën gjyqësore u është komunikuar palëve ndërgjyqëse, ku përfshihet edhe kërkesi, me qëllim dhënien e mundësisë për parashtrimin me shkrim të pretendimeve të tyre, përpara zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit. Në këtë kuptim, kërkesi nuk është vendosur në pozita jo të barabarta me palët e tjera në proces.

10.3 Për sa i përket *të drejtës së pronës*, argumentet e kërkesit për cenimin e kësaj të drejte janë të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese. Gjithashtu, nga palët e paditura në proces janë ngritur pretendime në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për mënyrën e njoftimit të kërkesit, llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë dhe mundësinë e parashkrimit të saj. Afati dhe parashkrimi i padisë janë bërë objekt i debatit gjyqësor dhe pjesë e vlerësimit të vendimeve. Ligji për shpronësimet justifikon ndërhyrjen, duke kufizuar të drejtën e pronës private për individët, kur kjo ndërhyrje bëhet për qëllime të zhvillimeve në infrastrukturë. Neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parashikojnë se e drejta e pronës mund të kufizohet për një interes publik. I tillë është edhe rasti objekt i këtij gjykimi kushtetues. Nga ana tjetër, ndërhyrja e Këshillit të Ministrave ka qenë proporcionale, pasi kërkesit i është dhënë një shpërblim i drejtë për pronën e shpronësuar. Gjykata e Lartë ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor. Nga ana e gjykatës është arsyetuar fakti i momentit të lindjes së të drejtës së kërkesit për paraqitjen e padisë dhe fakti se ai ka marrë dënim. Duke qenë se është provuar se kërkesi ka marrë dënim në një nga format e parashikuara nga ligji, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor.

11. Subjekti i interesuar, ARRSH-ja, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

11.1 Procedura e ndjekur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, për kalimin e çështjes nga seanca gjyqësore në dhomën e këshillimit, është ligjërishit e përcaktuar dhe njoftimi i vendimit të revokimit u është njoftuar palëve ndërgjyqëse, ku përfshihet edhe kërkesi si individualisht, ashtu edhe me shpallje. Kërkesi është njohur me rekursin e palëve të tjera në proces, ndaj të cilave nuk ka bërë kundërrekurs dhe ndaj tij janë respektuar të gjitha garancitë procedurale.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "F" dhe 134, pikat 1, shkronja "I" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të

garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin konkret, kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar. Duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7.7.2022, i cili ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor dhe që ka vendosur për masën e shpërblimit të tij nga shpronësimi, ai ka përmbushur edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 7.11.2022, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vëren se subjektet e interesuara kanë pretenduar se kërkuksi nuk ka ngritur asnjë argument të natyrës kushtetuese dhe pretendimet e tij kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, që për nga natyra hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe jo në juridiksionin kushtetues.

15. Në lidhje me pretendimet e kërkuksit Gjykata konstaton se ai ka pretenduar se i është cenuar e drejta e njoftimit, pasi nuk është njoftuar as për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe as për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

16. Gjithashtu, kërkuksi ka pretenduar se i është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak të arsytimit të bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë se afati i ankimit ndaj vendimit të shpronësimit fillon në momentin e botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe jo në momentin e njoftimit të drejtpërdrejtë nga autoritetet shtetërore, duke keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr. 8561/1999, si dhe duke cenuar kështu edhe të drejtën e pronës.

17. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuksit *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe pretendimet e subjekteve të interesuara se Gjykata nuk ka juridiksion për to, janë të pabazuara. Gjithashtu, Gjykata, në zbatim të parimit *iura novit curia*, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuksit për cenimin e së drejtës së pronës dhe standardit të arsytimit lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, çmon t’i analizojë ato në këndvështrim të neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës, sipas të cilave prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në këtë këndvështrim, nisur nga thelbi i këtyre pretendimeve të kërkuksit, ato do të analizohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar

18. Kërkuksi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka njoftuar atë dhe përfaqësuesen e tij as për zhvillimin e gjykimit dhe as për revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve, si dhe për vijueshmërinë e gjykimit në dhomën e këshillimit. Mungesa e këtij njoftimi i ka mohuar kërkuksit të drejtën për t’u mbrojtur, nëpërmjet paraqitjes së pretendimeve me shkrim.

19. Subjektet e interesuara pretendojnë se në rastin konkret nuk është kufizuar e drejta për akses në gjykatë, për sa kohë kërkuksi nuk provon se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tij. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje edhe nga rekursi i paraqitur nga kërkuksi. Gjithashtu, vendimi për revokimin e vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore u është komunikuar palëve ndërgjyqëse, ku përfshihet edhe kërkuksi, me qëllim dhënien e mundësisë për parashtrimin me shkrim të pretendimeve të tyre, përpara zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit. Në këtë kuptim, kërkuksi nuk është vendosur në pozita jo të barabarta me palët e tjera në proces.

20. Neni 42 i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

21. Në jurisprudencën kushtetuese për procesin e rregullt ligjor, Gjykata është shprehur se disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e standardeve të tjera. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, kjo e drejtë krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 5, datë 9.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se pas rekurseve të paraqitura nga kërkuesi dhe subjektet e interesuara, çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 26.7.2016, ku është caktuar edhe gjyqtari relator. Sipas akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, rezulton se më datë 12.7.2017 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ka vlerësuar se ai përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*), të cilat duhet të shqyrtoheshin në seancën gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse (*shih procesverbalin e seancës gjyqësore*). Në seancën gjyqësore të datës 5.12.2017, përfaqësuesja e kërkuesit, bazuar në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile, ka kërkuar kalimin procedural nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe shtyrjen e seancës gjyqësore, pasi nuk ishte njohur me rekursin e subjekteve të interesuara. Këto kërkesa janë pranuar nga Kolegji Administrativ dhe seanca është shtyrë për një datë tjetër (*shih procesverbalin e seancës gjyqësore*).

23. Më pas, me ndryshimin e përbërjes së Gjykatës së Lartë, është caktuar gjyqtari i ri relator, si edhe përbërja e re e Kolegjit Administrativ që do të shqyrtonte këtë çështje. Ky kolegji i ri, më datë 2.6.2022, ka vendosur revokimin e vendimit të caktimit në seancën gjyqësore të datës 12.7.2017 dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve (*vendimi i revokimit*). Ky vendim i kolegjit rezulton t'u jetë njoftuar subjekteve të interesuara, por nuk i është njoftuar kërkuesit, i cili nuk ka marrë dijeni për të (sipas shënimit të punonjësit të shërbimit postar, “adresa është e pamjaftueshme”). Më pas, Gjykata e Lartë, më datë 2.6.2022, ka bërë shpalljen e datës së shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit (referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe akteve të dosjes gjyqësore), duke caktuar datën 7.7.2022 për shqyrtimin e saj. Në përfundim të gjykimin, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga subjekti i interesuar, ARRSH-ja, përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 dhe ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit.

24. Referuar rekursit të subjektit të interesuar, ARRSH-së, Gjykata vëren se, ndër të tjera, ky subjekt ka pretenduar se kërkuesi e ka humbur të drejtën për të ngritur padi, pasi e ka paraqitur atë jashtë afatit ligjor 30-ditor nga marrja dijeni për VKM-në nr. 408/2011. Pikërisht për këtë shkak Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka rrëzuar padinë e kërkuesit (*shih paragrafin 7 të këtij vendimi*). Ndërkohë, siç është konstatuar edhe më lart, më datë 5.12.2017, për këtë çështje është zhvilluar një seancë gjyqësore, e cila, ndër të tjera, është shtyrë për shkak se përfaqësuesja e kërkuesit ka kërkuar të njëjti me rekursin e paraqitura nga subjektet e interesuara (*shih paragrafin 22 të këtij vendimi*). Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se përfaqësuesja e kërkuesit, pasi të njëjti me pretendimet e ngritura në rekurs nga subjektet e interesuara, më konkretisht nga ARRSH-ja, ku sipas së cilës padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, do të kishte mundësinë të paraqiste prapësimet e saj lidhur me to. Po kështu, Gjykata pranon faktin se duke pasur parasysh ecurinë e procesit deri në atë moment, i cili zhvillohej në seancën gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse, pritej që edhe prapësimet e kërkuesit për rekursin e paraqitura nga subjektet e interesuara të paraqiteshin po në seancën gjyqësore, për të cilën ai duhej të njoftohej.

25. Për sa më lart, në kuadër edhe të këtyre rrethanave (*shih paragrafin 24 të këtij vendimi*), si dhe në kushtet kur ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë (viti 2016), Gjykata evidenton se në rastin konkret njoftimi i vendimit të revokimit merr një rëndësi të

veçantë për ecurinë e mëtejshme të gjykimit dhe për garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Në vlerësimin e Gjykatës, Gjykata e Lartë nuk duhej të ishte mjaftuar vetëm me konstatimin e bërë nga shërbimi postar për pamjaftueshmërinë e adresës së kërkuarit, por duhej të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim komunikimin e vendimit të revokimit të kërkuarit. Në këtë mënyrë, nëse kërkuari do të ishte vënë në dijeni të këtij fakti, do të kishte marrë masat e nevojshme që prapësimet e tij për rekursin e paraqitura nga subjektet e interesuara, veçanërisht nga ARRSH-ja, t'i paraqiste në Gjykatën e Lartë, duke realizuar të drejtën e tij të mbrojtjes. Gjithashtu, Gjykata vëren se për sa i përket publikimit të njoftimit më datë 2.6.2022, për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, kërkuari i është lënë një kohë e pamjaftueshme për t'u njohur me të dhe për të paraqitur prapësimet e tij.

26. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuari, duke mos u njoftuar për vendimin e revokimit, është vendosur në pamundësi për të paraqitur prapësimet e tij për pretendimet e ARRSH-së për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor 30-ditor, pasi siç është vërtetuar edhe nga procesverbali i seancës gjyqësore i datës 5.12.2017, ai nuk ishte njohur me to. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arsyetimin e vendimit e ka bazuar vetëm mbi shkaqet e rekursit, sipas formulimit të tyre në momentin e paraqitjes së tij nga përfaqësuesja e kërkuarit. Në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos e njoftuar kërkuarin për vendimin e revokimit, e ka vënë atë në pamundësi për të paraqitur pretendimet e tij në lidhje me çështjen e zbatimit dhe veprimit të ligjit në kohë, duke i kufizuar në këtë mënyrë aksesin substancial në gjykim.

27. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së njoftimit është i bazuar¹.

B.2 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e pronës

28. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar atij të drejtën për t'u njoftuar drejtpërdrejt nga autoritetet shtetërore për shpronësimin e realizuar sipas procedurave të ligjit nr. 8561/1999. Gjithashtu, ai ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se afati i ankimit ndaj vendimit të shpronësimit fillon në momentin e botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe jo në momentin e njoftimit të drejtpërdrejtë nga autoritetet shtetërore, ka keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr. 8561/1999, duke cenuar të drejtën e pronës. Sipas kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar shkakun ligjor se përse vendimet e gjykatave më të ulëta duhej të ndryshonin dhe kërkesëpadia të rrëzohej. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme për afatin e paraqitjes së kërkesëpadisë në raport me momentin e botimit të aktit për shpronësimin në Fletoren Zyrtare.

29. Sipas subjekteve të interesuara, këto argumente të kërkuarit janë të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese. Gjithashtu, subjektet e interesuara kanë pretenduar se nga palët e paditura në proces janë ngritur pretendime në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për mënyrën e njoftimit të kërkuarit, llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë dhe mundësinë e parashkrimit të saj. Afati dhe parashkrimi i padisë janë bërë objekt i debatit gjyqësor dhe pjesë e vlerësimit të vendimeve. Sipas tyre, ligji për shpronësimet justifikon ndërhyrjen duke kufizuar të drejtën e pronës private për individët, kur kjo ndërhyrje bëhet për qëllime të zhvillimeve në infrastrukturë. Neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parashikojnë se e drejta e pronës mund të kufizohet për një interes publik. I tillë është edhe rasti objekt i këtij gjykimi kushtetues. Nga ana tjetër, ndërhyrja e Këshillit të Ministrave ka qenë proporcionale dhe kërkuari i është dhënë një shpërblim i drejtë për pronën e shpronësuar. Gjykata e Lartë ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor. Nga ana e gjykatës është arsyetuar fakti i momentit të lindjes së të drejtës së kërkuarit për paraqitjen e padisë dhe fakti se ai ka marrë dijeni. Duke qenë se është provuar se kërkuari ka marrë dijeni në një nga format e parashikuara nga ligji, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor.

¹ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Gentil Ibrahimit votuan për këtë pretendim si të pabazuar, me argumentin kryesor se mosmarrja dijeni efektivisht nga kërkuari për vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve, në kontekstin e rrethanave konkrete të çështjes nuk ka ndikuar në të drejtat e tjera procedurale me pasoja antikushtetuese.

30. Gjykata ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin kur kushtet e paraqitjes së ankimit ose padisë, siç është afati, janë përcaktuar nga ligji, Gjykata ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. E drejta e individit të shpronësuar për të pasur akses në gjykatë, e cila është e parashikuar shprehimisht në nenin 41, pika 5, të Kushtetutës, është garanci specifike e së drejtës së pronës, kur kjo e fundit kufizohet nga shteti me anë të shpronësimit. Me anë të kësaj garancie procedurale, të shpronësuarit i jepet mundësia të përmbushë edhe garancinë tjetër kushtetuese me natyrë materiale – atë të shpërblimit të drejtë. E thënë ndryshe, e drejta e aksesit lidhet nga pikëpamja organike dhe funksionale me shpërblimin e drejtë. Për ushtrimin efektiv të këtyre garancive kushtetuese merr rëndësi përcaktuese njoftimi efektiv i individit për vendimin e shpronësimit dhe rezultatin e tij në drejtim të masës së shpërblimit, pasi mungesa e njoftimit do ta vendoste atë në pamundësi për t'u mbrojtur në rast arbitrariteti për masën e shpërblimit për pasurinë e shpronësuar, sepse në thelb do t'i mohonte të shpronësuarit aksesin në gjykatë (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në çështjen konkrete vërehet se VKM-ja nr. 408/2011, me të cilën është shpronësuar kërkuksi nga pasuria e tij private, është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 21.6.2011, por nuk ka asnjë të dhënë që t'i jetë njoftuar drejtpërdrejt atij nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin. VKM-ja nr. 408/2011 rezulton t'i jetë njoftuar kërkuksit me shkresën nr. 5613 prot., datë 23.9.2011 të DPRR-së, nëpërmjet së cilës i kërkohej dorëzimi i dokumentacionit të plotë të pronësisë dhe numri i llogarisë bankare (IBAN), për likuidimin e vlerës së përcaktuar për shpronësim në bazë të kësaj VKM-je (*shih paragrafin 2 të këtij vendimi*). Kërkuksi më datë 13.10.2011, 20 ditë pas njoftimit të VKM-së nga DPRR-ja, është ankuar për vlerën e shpronësimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin përfundimtar ka pranuar padinë e tij. Vendimi është lënë pjesërisht në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Këto gjykata janë shprehur edhe në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, sipas të cilave kërkuksi i është drejtuar gjykatës brenda afateve ligjore, pasi më parë ka ndjekur rrugën administrative dhe pas përgjigjes nga organi administrativ, brenda afatit 30-ditor, i është drejtuar rrugës gjyqësore. Më pas, përveç kërkuksit, kanë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë edhe Avokatura e Shtetit dhe ARRSH-ja, ku, ndër të tjera, kjo e fundit ka pretenduar se ai (kërkuksi) është jashtë afatit ligjor për ngritjen e padisë, pasi VKM-ja nr. 408/2011 është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 8.6.2011, ndërsa padia është ngritur në gjykatë më datë 26.10.2011, pra jashtë afatit 30-ditor të njoftimit të VKM-së. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin dhe ka arritur në përfundimin se ai përmbante shkaqe të parashikuara në ligj, duke vlerësuar në vijim se gjykatat më të ulëta duhej të kishin rrëzuar padinë për shkak se ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor, e duke qenë se ato nuk e kanë bërë një gjë të tillë, ai kolegji ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë.

34. Në thelb, pretendimet e kërkuarit të paraqitura në këtë Gjykatë lidhen me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar dispozitat ligjore për llogaritjen e afatit, brenda të cilit ai si i shpronësuar ushtron të drejtën e ankimit në gjykatë për masën e shpërblimit nga shpronësimi, sipas ligjit nr. 8561/1999. Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit të kundërshtuar, vërehet se Gjykata e Lartë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se parashikimi i ligjit nr. 8561/1999 për njoftimin e drejtpërdrejtë të të shpronësuarit nuk zhvlerëson ose përjashton efektet ligjore dhe prezumimin ligjor të marrjes dijeni të palëve të interesuara në momentin e botimit në Fletoren Zyrtare të VKM-së për shpronësimin. Botimi në Fletoren Zyrtare është garancia maksimale që ligji ka vendosur për mbrojtjen e të drejtave të të shpronësuarve, pasi nëpërmjet botimit në Fletoren Zyrtare prezumohet njohja e vetë ligjit, për rrjedhojë edhe e akteve të tjera me rëndësi më të ulët ligjore, siç janë aktet individuale. Njoftimi individual gjen zbatim në periudhën e ndërmjetme midis momentit kur miratohet VKM-ja për shpronësimin, e cila hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet me miratimin e saj dhe momentit kur ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare. Gjykata e Lartë, duke konstatuar se VKM-ja nr. 408/2011 për shpronësimin është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 21.6.2011, ka vlerësuar se në këtë ditë ka filluar afati ligjor i paraqitjes së padisë. Si pasojë e këtij interpretimi, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se padia e paraqitur nga kërkuari është jashtë afatit ligjor dhe, për këtë shkak, ka vendosur rrëzimin e padisë pa i dhënë përgjigje përfundimtare pretendimit për vlerën e shpërblimit nga shpronësimi, duke ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta që kishin shqyrtuar themelin e pretendimeve dhe i kishin pranuar pjesërisht ato.

35. Në lidhje me interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 8561/1999, që lidhen me njoftimin e aktit të shpronësimit drejtpërdrejt individit të shpronësuar, Gjykata ka pranuar se në përputhje me parimin themelor të sigurisë juridike, e drejta e aksesit në gjykatë e individit të shpronësuar është e kufizuar nga afati ligjor brenda të cilit duhet të paraqitet padia. Për rrjedhojë, ajo ka vlerësuar nga pikëpamja kushtetuese nëse interpretimi i ligjit për mënyrën e njoftimit dhe llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuarit për masën e shpërblimit të drejtë nga shpronësimi (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Sipas Gjykatës, aksesit në gjykatë i të shpronësuarit duhet të garantojë në nivelin e duhur ushtrimin e të drejtave të tij, si mjeti i vetëm me anë të të cilit ai mund të mbrohet në rast arbitrariteti të ndërhyrjes shtetërore, si dhe për të siguruar që kjo ndërhyrje në të drejtën e pronës private ka qenë proporcionale (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa, për sa i përket ligjit nr. 8561/1999, Gjykata ka vlerësuar se ai nuk ka përcaktuar shprehimisht njoftimin e të shpronësuarit përmes botimit zyrtar, edhe pse parashikon se vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare (*neni 21, pika 5*). Ky parashikim duket se është në linjë me rregullin e përgjithshëm për botimin e akteve individuale të këtij organi sipas ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” (*neni 29, pika 3*). Ky rregull i shërben transparencës së veprimtarisë shtetërore dhe së drejtës kushtetuese të qytetarëve për informim, në kushtet kur sipas nenit 100, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe i zhvillon mbledhjet e tij të mbyllura (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Për sa më sipër, Gjykata rithekson se për sa i takon njoftimit të akteve publike të shpronësimit, institucionet shtetërore të përfshira në procesin e shpronësimit duhet të tregojnë kujdes të shtuar dhe duhet të interpretojnë e zbatojnë dispozitat ligjore në atë mënyrë që t’i garantojnë individit garancitë kushtetuese të parashikuara në nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 1.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Me fjalë të tjera, Gjykata evidenton se në procedurën e shpronësimit, për shkak se e drejta kushtetuese e pronës preket dhe në funksion të garantimit të aksesit në gjykatë, organet publike kanë detyrimin të realizojnë një njoftim të rregullt efektiv të individit, me qëllim që ai të ketë mundësinë e mbrojtjes për vlerën e pronës në procesin administrativ, përfshirë edhe atë të mbrojtjes gjyqësore në rast të ushtrimit të së drejtës së ankimit për masën e shpërblimit. Për të njëjtat arsye, është e rëndësishme që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kur shqyrtojnë ankime për vlerën e pasurisë së shpronësuar, të verifikojnë realizimin e njoftimit nga organet publike, për t’i dhënë peshën e duhur

vlerës dhe pasojës juridike të tij në drejtim të aksesit të individit në gjykatë, si garanci e posaçme kushtetuese në procedurën e shpronësimit. Një vlerësim i ndryshëm nuk do të garantonte ekuilibrin e drejtë mes të drejtave kushtetuese relevante në një proces shpronësimi, duke krijuar barrë të tepruar për individin në favor të shtetit (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë për njoftimin dhe llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi ka vënë theksin në njoftimin nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare, duke zbehur vlerën juridike dhe pasojat që shkakton njoftimi individual i tij tek i shpronësuarit (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 1.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se edhe në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke llogaritur afatin e paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi me njoftimin nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe duke mos i dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuesit për masën e dëmshpërblimit si pasojë e shpronësimit, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit, edhe pse ai e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë brenda afatit 30-ditor të njoftimit të VKM-së nr. 408/2011.

41. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e pronës, për shkak të interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, është i bazuar dhe vendimi i saj duhet të shfuqizohet.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1756 (262), datë 7.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 25.4.2023.

Shpallur, më 24.5.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Elsa Toska Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim